



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Statistikat Sociale

Niveli i Pagave në Kosovë 2012-2016



Prishtinë,
Nëntor, 2017

Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon, për herë të parë, pagën mesatare për:

- Sektorin Publik (Administrata),
- Sektorin Privat, dhe
- Ndërmarrjet publike

Ky raport është hartuar në bazë të kërkesës dhe nevojës nga shfrytëzuesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe shfrytëzuesit e ndryshëm. Të dhënat e prezantuara në këtë raport, për pagën mesatare, janë të dhëna transparente, që do t'u ndihmojë vendimmarrësve në orientimin e politikave të tyre dhe në planifikimin e mënyrave më efektive në mbajtjen dhe motivimin e punonjësve

Niveli i pagës është një e dhënë shumë e rëndësishme, jo vetëm për organizatat, që e shfrytëzojnë si bazë për të bërë ndryshime (ritje/ulje), por njëherit është edhe tregues shumë i rëndësishëm për investitorët e rinj dhe çelës a instrument tërheqës për të marrë kandidatë më të mirë.

Kur një organizatë është e përbërë nga njerëz të aftë dhe të motivuar nuk mungojnë edhe sukseset. Strukturat e pagave janë pjesë e domosdoshme e menaxhimit efektiv. Për qasje më të lehtë të shfrytëzuesëve, në këtë raport është dhënë paga mesatare bruto dhe neto.

Ky është raport preliminar me të dhëna për vitin 2012-2016 derisa, nga viti i ardhshëm, ASK-ja do t'i publikojë rregullisht të dhënat për pagën mesatare në nivelin më të ulët, sipas sektorëve ekonomikë.

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së

Isa Krasniqi

Publikimin e përgatitën:

Avni Kastrati - Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale/Popullsisë
Naime Rexhepi, Shefe e Divizionit të Statistikave Sociale,
Bujar Hajrizi, Shef i Sektorit të Tregut të Punës,
Bedrije Demaj, Zyrtare e lartë e Tregut të Punës,
Muhamet Kastrati, Specialist i TI-së për RSB-së

Redakturë gjuhësore:

Hazbije Qeriqi – Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja, lidhur me këtë publikim, janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net

Shkurtesat

MAP – Ministria e Administratës Publike

RSB - Regjistri Statistikor i Bizneseve

ARBK – Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

NACE - Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike

ISCO - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve

Përmbajtja

	Faqe
Hyrje.....	2
Shkurtesat	4
Definicione	7
Paga bruto.....	7
Paga neto	7
Spektori publik	7
Spektori privat.....	7
Ndërmarrjet publike	7
Burimi i të dhënave dhe metodologjia	8
Spektori publik	8
Metoda e llogaritjes së pagës mesatare vjetore/sektori publik	8
Spektori privat.....	8
Burimi i të dhënave.....	8
Përfshin	8
Nuk përfshin.....	8
Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë.....	8
Ndërmarrjet publike	9
Burimi i të dhënave.....	9
Niveli i pagës mesatare në Kosovë.....	9
Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë	10
Paga mesatare në sektorin publik.....	10
Paga mesatare në sektorin privat	10
Paga mesatare te ndërmarrjet publike	11

	Faqe
Pagat mesatare bruto sipas sektorëve	11
Paga mesatare neto sipas sektorëve	12
Paga mesatare në Kosovë dhe vendet e Rajonit.....	13
Paga minimale në Kosovë dhe vendet e Rajonit.....	14
Agjencia e statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër.....	15

Definicione

Paga bruto

Të ardhurat bruto të punonjësve, që përfshin të ardhurat për punën dhe kohën e kaluar në punë, të ardhurat e tjera personale, të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje kolektive (shtesat), ose kontratën e punës, në të cilën tatimi mbi të ardhurat personale do të zbatohet. Ndryshe, paga bruto është shumë e përgjithshme e pagës pa tatim dhe kontributet e zbritura (pension/kursime pensionale, sigurime shëndetësore, etj.).

Paga neto

Pagat neto janë tatimi dhe kontributet e zbritura nga paga bruto.

Sektori publik

Të gjithë të punësuarit, të cilët marrin pagë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës janë përfshirë në sektorin publik.

Sektori privat

Të gjithë të punësuarit, të cilët punojnë pranë ndërmarrjeve private (biznes privat), për të cilët ndërmarrjet paguajnë taksat dhe kontributet e tyre.

Ndërmarrjet publike

Ndërmarrjet publike përfshijnë të gjitha ndërmarrjet, që janë në pronësi publike, ose janë themeluar me fonde publike, ose sipas ligjit publik dhe nuk janë autoritete publike, ose pjesë të autoriteteve publike.

Burimi i të dhënave dhe metodologjia

Sektori publik

Burimi i të dhënave: të dhënat për sektorin publik janë nxjerrë nga Divizioni i Administrimit të Pagesave/ lista e pagesave të pagave nga Ministria e Administratës Publike (MAP) për pagën bruto dhe neto. Numri i marrësve të pagave në sektorin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) në dhjetor të vitit 2016 ishte gjithsej 81 629 persona¹.

Metoda e llogaritjes së pagës mesatare vjetore

Kalkulimi i pagës mesatare vjetore për sektorin publik është bërë sipas formulës:

$$\bar{x} = \frac{\sum_{i=1}^n x_i}{n} = \frac{x_1 + x_2 + \dots + x_n}{n}$$

- \bar{x} -prezanton simbolin për mesataren aritmetike të mostrës
- n - është numri total i vrojtimeve- elementeve
- x - prezanton vlerat individuale
- Σ - prezanton shumën e përgjithshme të vlerave.

Sektori privat

Burimi i të dhënave: për sektorin privat janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), që përmban të gjitha ndërmarrjet (publike dhe private), që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës.

Përfshin: të gjithë sektorët ekonomikë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2.

Nuk përfshin: Administratën Publike, Organizatat Jo-Fitimprurëse dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë: Burimet administrative (informacionet nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës), si dhe burimet statistikore (Anketa për Azhurnimin e RSB-së, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve dhe Anketat për Statistikat Afatshkurtra).

¹Në mesataren e pagave nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës (BKK), është përfshirë edhe fondi i kuadrove (shtesat).

Ndërmarrjet publike


Burimi i të dhënave: të dhënat për ndërmarrjet publike janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), baza e njëjtë si te sektori privat.

Niveli i pagës mesatare në Kosovë

Në vitin 2012, paga mesatare bruto në Kosovë ishin 431 Euro, derisa në vitin 2016 ishte 519 Euro, një rritje prej 88 Eurosh ose 20.42%. Derisa, paga neto nga 384 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 457 Euro në vitin 2016, me 74 Euro më shumë, ose 19.17%.

Tabela 1: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto, sipas viteve 2012-2016

Viti	Paga mesatare		Sektori publik (BKK)		Sektori Privat		Ndërmarrjet publike	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2012	431	384	407	353	367	333	518	465
2013	444	393	415	356	367	333	549	491
2014	482	430	465	408	358	326	624	556
2015	510	451	511	441	367	333	651	578
2016	519	457	525	449	371	337	660	586




Grafiku 1: Paga mesatare bruto dhe neto sipas viteve 2012-2016

Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë

Paga mesatare në sektorin publik


Paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2012 ishte 407 Euro, derisa në vitin 2016 ishte 525 Euro, duke u rritur për 118 Euro, ose 28.95%. Derisa, paga neto nga 353 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 449 Euro, një rrije prej 96 Eurosh, ose 27.09%.



Grafiku 2: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto në sektorin publik, 2012-2016

Paga mesatare në sektorin privat


Paga mesatare bruto në sektorin privat, në vitin 2012 ishte 367 Euro, derisa në vitin 2016 ishte 371 Euro, që u rrit me vetëm 4 Euro, ose 1.09%. Derisa, paga neto nga 333 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 337 Euro, me një rritje prej vetëm 4 Eurosh, ose 1.20%.



Grafiku 3: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto në sektorin privat, 2012-2016

Paga mesatare te ndërmarrjet publike


Paga mesatare bruto te ndërmarrjet publike, në vitin 2012 ishte 518 Euro, derisa në vitin 2016 ishte 660 Euro, që u rrit për 142 Euro, ose 27.41%. Derisa, paga neto nga 465 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 586 Euro, një rritje prej 121 Eurosh, ose 26.02%.



Grafiku 4: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto në ndërmarrjet publike, 2012-2016

Pagat mesatare bruto sipas sektorëve


Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte te ndërmarrjet publike. Në vitin 2012, te ndërmarrjet publike, paga mesatare bruto ishte 518 Euro, derisa në vitin 2016 arrinte në 660 Euro. Sektori publik, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare bruto 407 Euro dhe në vitin 2016 një pagë mesatare 525 Euro. Sektori privat ishte sektori me pagën më të ulët mesatare bruto dhe me një rritje shumë të vogël. Ky sektor, në vitin 2012 kishte një pagë mesatare 367 Euro, derisa në vitin 2016 kishte një pagë mesatare 371 Euro.



Grafiku 5: Niveli i pagave mesatare bruto sipas sektorëve, 2012-2016


Paga mesatare neto sipas sektorëve

Te ndërmarrjet publike, paga mesatare neto, në vitin 2012, arrinte nivelin 465 Euro, derisa në vitin 2016 arrinte në 586 Euro. Sektori publik, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare neto 353 Euro dhe në vitin 2016 një pagë mesatare neto prej 449 Eurosh. Sektori privat, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare neto 333 Euro, derisa në vitin 2016 kishte një pagë mesatare 337 Euro.



Grafiku 6: Niveli i pagës mesatare neto sipas sektorëve, 2012-2016

Jo të gjithë sektorët patën rritje të shprehur të pagave nëpër vite. Në sektorin publik, paga bruto, për periudhën 2012-2016, u rrit për 118 euro. Te sektori privat, kishte vetëm një rritje prej 4 Eurosh, brenda periudhës në fjalë, nga 367 në 371 Euro. Te ndërmarrjet publike, pati rritje më të madhe me 142 Euro më shumë se viti 2012. Paralel u rritën edhe pagat neto.



Grafiku 7: Rritja e pagës mesatare bruto dhe neto sipas sektorëve, 2012 - 2016

Paga mesatare në Kosovë dhe vendet e Rajonit

Pagat janë një ndër treguesit më të rëndësishëm për ta vlerësuar fuqinë blerëse. Derisa, për ta vlerësuar standardin jetësor të popullsisë së atij vendi/rajoni ndikojnë edhe faktorë të tjerë (kostot e ndryshëm të pagesave, si dhe çmimet e tregut).

Për ta vlerësuar nivelin e pagës mesatare të Kosovës janë marrë edhe pagat e vendeve të Rajonit, si: Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnje e Hercegovinës, Bullgarisë, Rumanisë dhe Moldavisë².

Burimi i të dhënave janë Agjencitë/Institutet Kombëtare të Statistikave të vendeve përkatëse.


Të dhënat tregojnë se vendet kanë nivele të ndryshme të pagës mesatare. Derisa paga mesatare bruto varion prej vendit në vend, ajo neto është më e përafërt.

Duket se faktorë determinues, që ka dallime në radhitjen e vendeve te paga bruto dhe neto është shuma/niveli që paguajnë ato shtete për taksa të ndryshme, si dhe për sigurimin shëndetësor. Kosova nuk paguan ende taksa për sigurimin shëndetësor.

Te paga bruto, nga 9 vende, që janë marrë si mostër, Kosova pozicionohet e katërta (4) për nga lartësia e pagave, derisa te pagat neto ajo radhitet pas Malit të Zi dhe Rumanisë, pra në vendin e tretë.


Tabela 2: Niveli i pagës mesatare në euro në Kosovë dhe vendet e Rajonit, 2016

Shtetet	Kosova	Shqipëria	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia	Bosnja	Bullgaria	Rumania	Moldavia
Bruto	519	408	422	751	516	669	543	510	271
Neto	457	375	372	499	374	428	410	465	212



Grafiku 8: Paga mesatare bruto në Kosovë dhe vendet e Rajonit, 2016

² Burim i të dhënave për pagën bruto dhe neto janë Institutet Kombëtare Statistike të vendeve përkatëse (4 shtete kanë dërguar të dhënat e kërkuara), si dhe Eurostat. Për shkak të valutës kombëtare ekzistuese në vendet përkatëse dhe llogaritjes së kursit të Euros, dallimi mund të jetë nga 1 deri në 3 Euro.




Grafiku 9: Paga mesatare neto në Kosovë dhe vendet e Rajonit, 2016

Paga minimale në Kosovë dhe vendet e Rajonit

Norma e pagës minimale është paga më e ulët e lejuar, zakonisht e rregulluar përmes ligjeve shtetërore. Ajo varion varësisht prej vendit në vend dhe në shumë vende sillet ndërmjet 20-50% të pagës mesatare. Në Kosovë, aktualisht paga minimale është e kategorizuar në 130 Euro për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare dhe 170 Euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare.

Tabela 3: Raporti i pagës minimale me pagën mesatare bruto dhe neto në Kosovë, 2016

Paga minimale	Bruto (%)	Neto(%)
130	25.07	28.43
170	32.79	37.17



Grafiku 10: Paga minimale në Kosovë dhe vendet e Rajonit, 2016

Agjencia e statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucion profesional, që merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si e tillë, vepron që nga viti 1948. ASK ka kaluar nëpër disa faza historike, e strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 gusht 1999, ASK-ja ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 vjetësh ndërprerjeje të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky institucion vepron në kuadër të Zyres së Kryeministrit të Kosovës. ASK-ja financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale. Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036, i cili ka hyrë në fuqi më 12.12.2011.

Programi i Statistikave Zyrtare, 2013-2017 është zbatuar për zhvillimin e Sistemit Statistikor të Kosovës në korrelacion me Statistikat e Bashkimit Evropian (Eurostat). ASK-ja ka strukturë organizative të tri departamenteve prodhuese dhe katër departamente mbështetëse. Departamentet prodhuese janë: Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, dhe Departamenti i Statistikave Sociale. Kurse, departamentet mbështetëse: Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative; Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim; Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit; si dhe Departamenti i Administratës. Në kuadër të ASK-së veprojnë edhe Zyrrat Rajonale: Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj. Numri i të punësuarve dhe buxheti ende janë të limituara. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në ASK, gjersa në Zyrrat Rajonale, 45 (31,5%). ASK ka këtë strukturë kualifikuese: 61,7% me shkollim universitar; 15,4 me shkollim të lartë; ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm. Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha ministritë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi, nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore, por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruer terreni nga Zyrrat Rajonale etj. Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë 2014.

Misioni i ASK-së përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme, që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset, si dhe hulumtuesit e pavarur. Në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendimmarrësit dhe përdoruesit e tjerë në Kosovë.